

## WUS Austria fton studentët për garën “Rasti sfidues i Kosovës 2008”

07.02.2008 13:08 ET Prishtinë (KosovaLive)

WUS-Austria, Zyra në Prishtinë, ftoi të enjten studentët kosovarë që të aplikojnë për programin “Kosova Case Challenge 2008” (Rasti sfidues i Kosovës 2008), me ç'rast studentët fitues të kësaj gare do të mund të marrin pjesë në finalen e madhe “Balkan Case Challenge”, që do të mbahet me 6-11 korrik në Vjenë.

But Dedaj, drejtor i WUS-Austria, Zyrës në Prishtinë, tha se programi “Kosova Case Challenge 2008”, është një sfidë për studentët kosovarë që dijen e tyre teorike ta zbatojnë edhe në praktikë.

Ai tha se “Rasti sfidues i Kosovës” synon në hapjen e mundësive dhe perspektivave të reja studentëve të shkëlqyer të Edukimit të Lartë të Kosovës duke i forcuar lidhjet në mes edukimit të lartë dhe punësimit si dhe ofrimin e shanseve konkrete për punë.

Duke shpjeguar programin e projektit, ai tha se gara studimore e bazuar në metodën e rastit studimor zhvillohet në katër disiplina: rasti biznesor që përfshin studentët e të gjitha fushave të ekonomikut; teknologjia informative dhe komunikuese që përfshin studentët e shkencave teknike; modeli i Këshillit të Evropës që përfshin studentët e shkencave politike, marrëdhënie ndërkombëtare, diplomaci, sociologji etj dhe rasti i katërt është simulimi i gjyqit e që do të përfshijë studentët e juridikut.

Dedaj, shpjegoi se kësaj here ky program ka disa objektiva: kompanive të ndryshme t'iu ofrojë studentë të shkëlqyer në mënyrë që t'i punësojë ata si kuadër, pastaj kompanitë problemet e ndryshme të tyre të mund t'i zgjedhin nga studentët të cilët konkurrojnë, mundësia që kompanitë të ofrojnë bursa për studentë, krijimi i rrjetit të komunikimit në regjion etj.

Sipas tij, nga praktikat e viteve të kaluara, studentët kosovar kanë treguar mjaft rezultate të larta, mirëpo sipas tij, ende është larg përgatitja e tyre gjatë studimeve për tregun e punës.

Për këtë arsye, kësaj radhe gara “Kosova Case Challenge 2008”, do të përbëhet nga tri pjesë: trajnimi për aplikues lidhur me garën e rastit studimor, gara ku fituesit nga çdo disiplinë do të selektohen për garën “Balkan Case Challenge”, që do të mbahet në Vjenë dhe ngjarja e rekrutimit.

Koordinatorja e projektit, Mjellma Carabregu, tha se interesimi më i madh për këtë garë është i studentëve të ekonomikut, ndërsa afati i konkurrimit ka filluar që nga 18 janari dhe do të vazhdojë deri më 31 mars, ndërsa gara në Kosovë do të mbahet gjatë periudhës 10-11 maj, ku fituesit do të kualifikohen direkt për finalen ndërkombëtare që do të mbahet me 6-11 korrik 2008, në Vjenë.

“Kosova Case Challenge 2008”, organizohet për herë të katërt, ndërsa nga 50 studentët që do të jenë në listën e ngushtë, 8-10 prej tyre do të arrijnë të marrin pjesë në garën e Vjenës.

Carrabregu duke treguar procedurat e konkurrimit tha se studentët që aplikojnë duhet të vërtetojnë se janë studentë të vitit të caktuar, duhet ta njohin gjuhën angleze, ndërsa preferohet të jenë student të vitit të fundit të studimeve themelore ose student në nivelin Master, mirëpo sipas saj nuk do të përjashtohen as edhe studentë në vitet e para të studimeve.

Këtë vit Balkan Case Challenge prezanton gjysmëfinalen në 11 vende të Evropës Juglindore duke e vazhduar traditën e saj në Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe

Serbi, ndërsa është duke u organizuar për herë të parë në Maqedoni, Mal të Zi, Moldavi, Bullgari, Kroaci, Rumani, Slloveni, si dhe në Austri./b.salihu/